



In medias res

Ku mund të zbatohen risitë në arsim ?

Dijet dhe risitë paraqesin kapitalin kryesor të secilit vend dhe komb me të cilat mund të sfidohet me sukses koha postmoderne, jo vetëm në arsim, por edhe në fushat tjera. Risitë janë instrumenti i rëndësishëm i përparimit të vazhdueshëm dhe i parandalimit të krizave në sistemin e arsimit.

Shkalla e efikasitetit dhe të efektivitetit të sistemit të arsimit është në përpjesëtim të drejtpërdrejt me shkallën e rinovimit të sistemit të arsimit. Të gjitha sistemet arsimore që janë në krizë, që janë të vjetruar dhe që nuk janë sinkron me zhvillimin teknik dhe teknologjik janë sisteme që nuk kanë bërë inovime, që nuk kanë zbatuar risi pozitive.

Risitë dhe rinovimet duhet të përdoren e në të gjitha fushat, në të gjitha etapat, në të gjitha nivelet e sistemit të edukimit dhe të arsimit.

Kështu për shembull, nëse për kriter marrim etapat e organizimit të sistemit të arsimit risitë mund të përdoren:

- a. në etapën përgatitore ose preparative
- b. në etapën operative – zhvillimore
- c. në etapën e verifikimit dhe të vlerësimit

Në etapën përgatitore risitë mund të përdoren në fushën e përgatitjes së planeve mësimore. P.sh. me qëllim të përgatitjes sa më të mirë për orë mund të përdoret teknikat bashkëkohore të planifikimit: Metodot e planifikimit rrjetor; metodat heuristike, metoda e gantogrameve, etj. Në fazën e përgatitjes është shumë me rëndësi shfrytëzimi i burimeve alternative. Inovacion në etapën e përgatitjes mund të jetë përdorimi i internetit, përgatitja e skedave të ndryshme për individualizmin e mësimi, përgatitja e testeve për pilot-vlerësime, përgatitja e transparencave, materialeve të ndryshme të shumëzuara, enigmave, rebuseve, etj. Në etapën përgatitore përdoren risitë që do të zbatohen edhe në etapat tjera të punës edukative. Kështu, në këtë etapë përgatiten metodologjitë e mësimdhënies, mjetet më të reja mësimore që mund të përdoren në procesin e edukimit dhe të arsimit, metodat, mjetet dhe instrumentet me të cilat bëhet vlerësimi i arritjeve në etapën e realizimit.

Studimet bashkëkohore kanë konstatuar se në mësimdhënien bashkëkohore etapa që më së shumti kërkon kohë, mund dhe angazhim është etapa preparative përkatësisht përgatitore. Në sistemet tradicionale të edukimit etapa në të cilën më së shumti ka qenë e fokusuar vëmendja ishte etapa operative. Këtu qëndron vija e demarkacionit - ndarjes ndërmjet mësimdhënies bashkëkohore dhe të mësimdhënies tradicionale.

Në etapën e realizimit mund të përdoren risitë e ndryshme që lidhen me metodologjitë e mësimdhënies: Metodot e zhvillimit të mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit, Metodologjia e Hap pas Hapit, Mësimi dhe të Nxëniti e Programuar, Të Nxëniti problemor, Të nxëniti me projekte, Të nxëniti dhe mësimdhënja kooperative, Mësimdhënja dhe të Nxëniti Ekzemplar, Mësimdhënja përmes zgjidhjes së problemeve; Mësimdhënja dhe të nxëniti kooperativ; Mikro-mësimi, Mësimdhënja dhe të nxëniti nëpërmjet Simulatorëve, Mësimdhënja distributive, Mësimdhënja ndërmjetësuese, Mësimdhënja dhe të nxëniti me ndihmën e kompjuterit, Mësimdhënja dhe të nxëniti kompjuterik; Mësimdhënja dhe të nxëniti në distancë ose e-nxënja, apo të nxëniti ON - Line. Risitë mund të bëhen në tekste, në kurrikula, në organizim etj. Sistemi i arsimit në Kosovë, nuk mund të sfidojë kohën postmoderne, pa një sistem permanent të rinovimit.

Shkroi: Halim Hyseni

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Në kuadër të Programit të MKLSH-së, më 6-7 dhjetor është mbajtur seminari i tretë “Leximi, Shkrimi dhe Diskutimi në çdo lëndë” për grupet e mësimitdhënësve që vijojnë trajnimin në Pejë, Ferizaj dhe Gjiilan, ndërsa i njëjti seminar është mbajtur më 13-14 dhjetor për grupet e mësimitdhënësve që vijojnë trajnimin në Prishtinë (2 grupe), në Mitrovicë dhe në Gjakovë. Nga raportimet e trajnerëve kuptohet se mësimitdhënësit e pëlqejnë shumë programin e trajnimit dhe përgatitjen e trajnerëve. Në fund të seminareve mësimitdhënësit janë njoftuar se trajnerët do të bëjnë monitorimin në klasa gjatë muajit janar.

■ Më 6 dhjetor 2008 në lokalet e Qendrës Didaktike në Gjakovë është mbajtur takimi gjysmë-ditor me mësimitdhënësit e grupit të dytë të Gjakovës, të cilët janë duke vijuar programin e MKLSH-së. Nga raporti i trajnerëve kuptohet se mësimitdhënësit kanë treguar performancë të shkëlqyer në zbatimin e teknikave dhe strategjive të MKLSH në klasat e tyre. Trajnerët kanë inkurajuar mësimitdhënësit që edhe më tutje të vazhdohet me një përkushtim të tillë. Ndërsa ky grup vijoi seminarin e katërt “Teknika tjera për zhvillimin e mendimit kritik” më 13-14 dhjetor 2008.

■ Në Podujevë më 13-14 dhjetor ka filluar trajnimi me vetëfinancim i 36 mësimitdhënësve të komunës së Podujevës. KEC me këtë rast ka dhuruar si donacion kompletin e udhëzuesve 1-8 për secilin pjesëmarrës si përkrahje iniciativave të mësimitdhënësve për zhvillim profesional. Raporti nga seminari tregon se çdo gjë ka shkuar sipas planifikimit.

Hap pas Hapi

■ Gjatë muajit dhjetor kanë vazhduar monitorimet nëpër institucione të ndryshme shkollore dhe parashkollore, të cilat punojnë me metodologjinë Hap pas Hapi.

Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Gjatë muajit dhjetor 2008 , është hartuar Raporti narrativ dhe financiar për periudhën shator – dhjetor 2008. Me datën 10 dhjetor 2008, KEC në bashkëpunim me UNICEF kanë organizuar një tryezë të rumbullakët në pjesën veriore të Mitrovicës në temën: “Dhuna në shkolla”. Në tryezë, kanë marrë pjesë 20 pjesëmarrës. Në fillim organizata joqeveritare “Amity” shkurtimisht kanë prezantuar hulumtimin e tyre.

Mbi bazën e prezantimit ka filluar debati, në të cilën janë konstatuar shumë probleme siç janë: besimi i luhatur i nxënësve ndaj mësimitdhënësve, komunikimi i pamjaftueshëm në relacionin prindër mësimitdhënës, mungesa e përmbajtjeve alternative, politizimi i shkollave, mungesa e programeve edukative për mësimitdhënës, sistemi i vjetruar i arsimit etj.



■ Me datën 18.12 2008, në lokalet e KEC është mbajtur tryeza e rrumbullakët në të cilën kanë marrë pjesë 26 përfaqësues nga MASHT, dhe organizata të ndryshme jo qeveritare. Në këtë tryezë është bërë promovimi i dy publikimeve: “Barazia gjinore në tekstet e arsimit të detyruar në Kosovë” botuar nga KEC dhe “Parandalimi i delikucencës së miturve”, botuar nga Qendra për të drejta e njeriut.



Në këtë tryezë të rrumbullakët janë paraqitur edhe këto prezantime: Hulumtimi i dhunës ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës (UNICEF); Dhuna dhe pasojat psiko-sociale të dhunës (Shoqata për Ndihmë Psiko-sociale për Fëmijë dhe familje); Dhuna në shkolla dhe mekanizmat për parandalimin e dhunës (MASHT); Ngritja e kapaciteteve për parandalimin e dhunës (Care International)

Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II

■ Shkollat pjesëmarrëse në ciklin shtesë të Projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim gjatë muajit dhjetor kanë përgatitur planet zhvillimore të shkollës dhe projektet shkollore. Këto plane e projekte janë vlerësuar në nivelin lokal nga Ekipet Komunale për Grante Shkollore, ndërsa pritjet që në pjesën e parë të muajit janar

2009 të shqyrtohen dhe aprovohen nga Këshilli për Aprovimin e Granteve Shkollore. Pas aprovimit, shkollat do të realizojnë projektet e tyre.

Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim

■ Në kuadër të projektit “Monitorimi i Implementimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve RAE në Arsim”, këtë muaj është bërë edhe monitorimi i dytë i kësaj Strategjie. Rezultatet e monitorimit janë gërshetuar bashkë me një debat-diskutim publik të mbajtur në Grand Hotel, në Prishtinë, më 22 dhjetor 2008, ku u diskutua gjerë e gjatë për punën e këtyre komuniteteve, dhe mënyrën për implementim sa më të mirë të kësaj Strategjie.



Pjesëmarrës në këtë takim ishin anëtarët e grupit për monitorim, përfaqësuese të komuniteteve RAE si dhe një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve nga shoqëria civile.

Mentorimi i projekteve për përkrahje të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

■ Gjatë këtij muaji janë është vazhduar me vizitat në terren. Pasiqë është

muaji i fundit i këtij projekti këto vizita u bënë me qëllim të verifikimit të finalizimit të aktiviteteve që janë zhvilluar nga qendrat. Këto vizita janë zhvilluar edhe me përfituesit e projekteve.

Në fund të këtij projekti do të hartohet një raport përmbledhës, ku do të përfshihen të gjitha aktivitetet dhe arritshmëritë e këtij projekti.

KOSOVISION Contest

■ Në fillim të këtij muaji në Prishtinë është hapur ekspozita e punimeve të të gjitha klasave pjesëmarrëse në projekt. Ekspozita ishte në dispozicion për të interesuarit për pesë ditë radhazi. Pjesëmarrja e madhe e vizitorëve, respektivisht fëmijëve në ekspozitë ka zgjuar kureshtje edhe më të madhe për nxënësit që edhe më tutje të vazhdojnë me projekte të tilla siç është KOSOVISION CONTEST.



■ Po ashtu, në kuadër të këtij projekti është mbajtur edhe një takim gjysmë ditor me stafin lokal-ndihmës të këtij projekti. Në takim u diskutuan dhe u analizuan të gjitha vërejtjet, sugjerimet,

mënyra e punës së stafit, vështirësitë e tyre gjatë zbatimit të projektit, etj. Menaxherët e projektit u ndanë shumë të kënaqur me të arriturat e deritanishme në këtë projekt.

■ Në kuadër të projektit është mbajtur edhe një takim me udhëheqësit, partnerët e projektit të cilët diskutuan për mënyrën e implementimit të fazës së dytë të projektit.

Access Microscholarship Program

■ Gjatë dhjetorit ka vazhduar mbajta e testeve dhe intervistave për nxënësit e interesuar për programin Access Microscholarship Program. Janë përzgjedhur dy grupe nxënësish në Prishtinë dhe një grup në Prizren.

■ Me 15, respektivisht 17 dhjetor 2008, në Prishtinë kanë filluar mësimin e gjuhës angleze dy grupe me nxënës shqiptarë dhe serbë.

■ Grupi i nxënësve në Prizren është i përbërë nga nxënës shqiptarë, turq dhe boshnjak. Ata kanë filluar mësimin me 23 dhjetor 2008.

Cilësia e arsimit në regjionin e Dukagjinit (AVSI-CESAL)

■ Gjatë dhjetorit është hartuar lista me emrat e shkollave të cilat do të marrin pjesë në këtë hulumtim. Pasi jemi në fund të këtij gjysmëvjetori, mendohet që plotësimi i pyetësorëve të fillojë në gjysmëvjetorin tjetër, do të thotë, nga data 11 janar do të fillohet me distribuimin dhe plotësimin e pyetësorëve.

Përgatiti: Petrit Tahiri